



Pranuar - Prilbena Meqiana: 26.09.2024

Nr i organit broj Organa	Numri-Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
05-	320/01	-	-

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Nenit 10, paragrafi 2 të Rregullores (qrk) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitars dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ MASHTI nr.01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti, shpall:

### KONKURS PËR MËSIMDHËNËS PËR NJË PERIUDHË TË CAKTUAR KOHORE

Nr .	Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vend i lirë/ Zëvendësim	Koeficienti i pagës
1	I mesëm i ulët	“ Dom Mikel Tarabolluzi”,	Stubëll e Epërme	Mësimdhënës/e për lëndën Biologji	Zëvendësim	E-19, 5.6
2	I mesëm i ulët	“ Nijazi Rexhepi”,	Sllatinë e Epërme	Mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë gjermane  Mësimdhënës/e për lëndën Gjeografi	Zëvendësim  Zëvendësim	E-19, 5.6
3	I mesëm i ulët	Sh.f.m.u. “ Skender Emërllahu”	Ramjan	Mësimdhënës/e për lëndën Gjeografi	Zëvendësim	E-19, 5.6
4	I mesëm i ulët	Sh.f.m.u. “ Hasan Alia”	Remnik	Mësimdhënës/e për lëndën Fizikë	Vend i lirë	E-19, 5.6
5	I mesëm i ulët	Sh.f.m.u. “ 28 Nëntori”	Vërban	Mësimdhënës/e për lëndën Histori Ed. qytetare	Zëvendësim	E-19, 5.6

## Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë rregullore.

## Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë) ose shkarkohet nga uebfaqja e komunës
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim (kontratat e punës ose vërtetim nga shkolla, nëse ka)

## Vlerësimi i kandidatëve:

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:

- c) Testit me shkrim, i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- d) Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm.

## Informata të përgjithshme :

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në zyrën e Arkivës të Komunës së Vitisë, kati përdhësë në ndërtesën e Administratës së Komunës së Vitisë dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në Zyrën e Arkivës apo të dërgohet me postë në këtë adresë: Komuna e Vitisë, Rr. Hasan Kabashi, pa nr. Viti. Konkursi dhe rezultatet shpallen web faqen <https://kk.rks-gov.net/viti/category/konkurse-njoftimet/konkurset/>

Konkursi është i hapur **5 ditë**, aplikimi bëhet nga data **26.09.2024 deri më 30.09.2024**

Konkursi publikohet në uebfaqen zyrtare të Komunës

Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

**Datë 26.09.2024**

**Drejtori/ja i/e DKA-së**

